



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2571 / Prot. 3

Tiranë, më 16.10.2020

V E N D I M

Nr. 2

**“PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.1, DATË 08.10.2020, “PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE NGA KANDIDATËT NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË””**

Bazuar në nenet 37 dhe 135, të ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të nenit 11 dhe 107 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pas administrimit të vendimit nr. 448, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vendimit nr. 213, datë 13.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

**VENDOSA:**

1. Revokimin e Vendimit nr. 1, datë 08.10.2020 “Për Shpalljen e Vendeve Vakante nga Kandidatët nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës për Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.
2. Publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë [www.parlament.al](http://www.parlament.al), së bashku me vendimin nr. 448, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vendimit nr. 213, datë 13.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 448, datë 15.10.2020**

**PËR**

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 5, DATË 20.12.2018, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR “MBI CAKTIMIN ME SHORT TË MANDATIT 3-VJEÇAR TË ANËTARËVE GJYQOTARË DHE ANËTARËVE JOGJYQOTARË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 179, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 276, pika 7 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë” pas pikës II të vendimit, shtohen pikat III dhe IV, si më poshtë:
  - “III. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat tre vjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2021”.
  - “IV. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat pesë vjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2023.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe versioni i konsoliduar i vendimit publikohet në faqen e internetit të Këshillit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**KRYETARE**

**NAUREDA LLAGAMI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr. 213, datë 13.10.2020

**PËR PËRLLOGARITJEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË  
KËSHILLIT**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 149, 149/b, 179, pika 6, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 280 të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në referencë të Vendimit nr. 01. dt.19.12.2018 të KLP-së, dhe relacionin bashkëlidhur,

**V E N D O S I:**

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë :

- Gent Ibrahim, anëtar jo prokuror (i zgjedhur nga trupa e pedagogëve).
- Sandër Beci, anëtar jo prokuror (i zgjedhur nga trupa e pedagogëve).
- Kostaq Beluri, anëtar prokuror (i zgjedhur nga asambleja e prokurorëve).
- Vatë Staka, anëtar prokuror (i zgjedhur nga asambleja e prokurorëve, zëvendëson mandatin e ish anëtarit, Antoneta Sevdari)
- Arben Dollapaj, ish-anëtar prokuror (zgjedhur nga prokuroria Apel, aktualisht vend vakant),

kanë mandat 3 (tre) vjeçar të siguruar nga shorti i hedhur në mbledhjen e parë të Këshillit, më datën 19 dhjetor 2018, datë në të cilën kanë filluar të ushtrojnë detyrën si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Mandati i tyre përfundon më datën 18 dhjetor 2021.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

- Alfred Balla, anëtar jo prokuror (i zgjedhur nga shoqëria civile).
- Bujar Sheshi, anëtar prokuror (i zgjedhur nga asambleja e prokurorëve).
- Esmeralda Keshi, anëtar prokuror (i zgjedhur nga asambleja e prokurorëve, zëvendëson mandatin e ish anëtarit, Gent Osmani).
- Nurihan Seiti, anëtar jo prokuror (e zgjedhur nga trupa e avokatisë).
- Tartar Bazaj, anëtar jo prokuror (i zgjedhur nga trupa e avokatisë).
- Besnik Cani, ish anëtar prokuror (zgjedhur nga prokuroria e shkallës së parë, aktualisht vend vakant),



kanë mandat 5 (pesë) vjeçar të siguruar nga shorti i hedhur në mbledhjen e parë të Këshillit, më datën 19 dhjetor 2018, ditë në të cilën kanë filluar të ushtrjnë detyrën si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Mandati i tyre përfundon më datën 18 dhjetor 2023.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETARI**  
**GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETARI**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR**  
**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**  
**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**  
**SANDËR BECI**

**ANËTAR**  
**VATË STAKA**

**ANËTAR**  
**TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR**  
**ESMERALDA KESHI**

